



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo -Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit  
P-98  
Prishtinë, më 30 mars 2010, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 30 MARS 2010

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Naim Maloku, Nexhat Daci, Slllobodan Petroviq dhe Etem Arifi, anëtarë të Kryesisë.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli, Petar Miletiq Xhezair Murati dhe Numan Baliq.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Selman Ymeri dhe Shefqet Rexhepi;

Nga Presidenca e Kosovës, Lumnije Murati;

Nga NDI, Shefki Kastrati;

Nga ZCN Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi edhe tri kërkesa shtesë dhe atë:

1. Kërkesa e Komisionit për Administratë publike, pushtet lokal dhe media për lejimin e vizitës zyrtare ne Kuvendin e Sllovenisë,
2. Kërkesa për lejimin e shpenzimeve shtesë nga udhëtimi zyrtar në Bruksel,
3. Njoftimi i deputetëve të PDAK për (mos) marrëveshje të mandatit në Kryesi, me rotacion

Kryesia, me propozimin e Kryetarit., miratoi

### **R e n d d i t e**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 mars 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, i rekomandimeve dhe i kërkesave.

#### **1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 mars 2010**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 23 mars 2010, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme të Kuvendit**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca e ardhshme e Kuvendit të mbahet me **15 prill 2010**, me këtë

### **R e n d d i t e**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Administratën Shtetërore të Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ujitjen e tokave bujqësore,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Gjykatat,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet postare,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mërgatën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjetllës dhe Mbeturina.

### **3. Mocione, rekomandime dhe kërkesa:**

#### **3.1 Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Legjislacion e Gjyqësi dhe të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për procedimin e Peticionit të Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit**

**Kryetari** njoftoi anëtarët e Kryesisë se dy komisionet parlamentare, ai për Legjislacion e Gjyqësi dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, kanë shqyrtuar Peticionin e Këshillit kundër procesit gjyqësor ndaj Albin Kurtit dhe Kryesisë së Kuvendit i kanë rekomanduar që në njëhën nga seancat e ardhshme, ta radhisë për shqyrtim këtë çështje.

Për këtë pikë diskutuan: Sabri Hamiti, Ardian Gjini, Nexhat Daci, Jakup Krasniqi, Ibrahim Makolli, Naim Maloku, Numan Baliç, Xhavit Haliti, Eqrem Kryeziu, Ramë Buja dhe Ibrahim Gashi.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimet e cekura më lart, vendosi të mbajë seancë plenare më 8 prill 2010 me këtë

R e n d d i t e

1. Debat për ngjarjet e 10 shkurtit 2007.

#### **3.2 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Arsim Rexhepi, për mundësinë e mbajtjes të seancave plenare të Kuvendit në orët e pasdites**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur m[, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Me Rregullore të Punës së Kuvendit nuk është përcaktuar koha, përkatësisht ora e fillimit me punë të seancës plenare. Fillimi i seancave plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës do të vazhdojë sipas praktikës së deritashme.

#### **3.3 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit, Arsim Rexhepi, për transmetimin e seancave plenare edhe në televizionet e tjera**

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

Transmetimi i seancave të Kuvendit të Republikës së Kosovës është aranzhuar më parë përmes Televizionit publikë-RTK-së.

Kërkesa për transmetim të seancave të Kuvendit mund të bëhet edhe nga televizionet e tjera, për të cilat Kryesia e Kuvendit në përputhje me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

### **3.4 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Mihajlo Shqepanoviq për lejimin e parkimit të makinës në parkingun e Kuvendit**

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Kërkesën e deputetit Mihajlo Shqepanoviq lidhur me parkimin e veturës në parkingun e Kuvendit ta shqyrtojë Sekretari i Kuvendit, z. Ismet Krasniqi.

### **3.5 Shqyrtimi i kërkesës së Grupit Joformal i Grave Deputete për realizimin e mëditjeve për deputeten Flora Brovina, me rastin e pjesëmarrjes në sesionin e VII të punëtorisë regjionale për deputetet GDF, në Zagreb nga 22 – 24 mars 2010**

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet realizimi i mëditjeve për deputeten Flora Brovina, me rastin e vizitës zyrtare në Zagreb, Kroaci, nga 22-24 mars 2010.

### **3.6 Shqyrtimi i kërkesës për lejimin e shpenzimeve shtesë për „Java e Kuvendit“**

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Organizimi Java e Kuvendit të Kosovës, prej 15 - 26 mars 2010 do të mbahet edhe në komunën e Graçanicës.
2. Për organizimin e aktivitetit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi lejohen shpenzimet shtesë reprezentative në shumën deri 1.500 euro, të cilat përballohen nga buxheti i Kuvendit.

#### **Pikat shtesë:**

1. **Kërkesa e Komisionit për Administratë publike, pushtet lokal dhe media për lejimin e vizitës zyrtare ne Kuvendin e Sllovenisë**

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

## V E N D I M

- 1 Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media: Esat Brajshori, Hajredin Hyseni, Shpresa Murati, Hajdin Abazi, Melihate Termkolli, Ali Lajçi, Synavere Rysha, dhe Numan Baliç, si dhe dy zyrtarëve të administratës së Kuvendit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta, në Republikën e Sllovenisë prej 13 mars deri më 18 prill 2010.
- 2 Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi i mbulon Programi i USAID-it i quajtur “FORECAST”, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohen nga buxheti i Kuvendit.

### **2. Kërkesa për lejimin e shpenzimeve shtesë nga udhëtimi zyrtar në Bruksel**

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, mori këtë

## V E N D I M

Lejohet mbulimi i shpenzimeve shtesë të udhëtimeve zyrtare në Belgjikë dhe në SHBA, sipas vendimeve nr. 03-V-248 dhe nr. 03-V-258.

### **3. Njoftimi i deputetëve të PDAK për (mos) marrëveshje të mandatit në Kryesi, me rotacion**

Kryesia pasi shqyrtoi këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë

## P Ë R F U N D I M

Çështja e përfaqësimit të deputetëve të PDAK-së në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, duhet të zgjidhet me marrëveshje brenda deputetëve të kësaj partie dhe të njoftohet Kryesia e Kuvendit.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në ora 12:20 minuta.

Hartoi: Divizioni për çështje plenare dhe procedurale